




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPALITY OF GJILAN/GILAN
BELEDIYESI



Njesia për Rini, Kulturë dhe Sport

Raport 6-mujor i sektorit për Kulturë.
Për periudhën Janar – Qershor 2016.
Nga: Bashkim Nexhipi , Udhëheqës i NJKRS.

FLAKA E JANARIT

Këtë vit FLAKA E JANARIT 2016 si zakonisht u zhvillua brenda periudhës 11.01.2016 -31.01.2016 por këtë vit me shumë Risi e aktivitete të ndryshme nga vitet tjera paraprahe. –Vit Jubilar -25 Vjet me Flakën e Janarit dhe me një brend ndryshe dhe aktivitete dhe me një organizim super lativ.

Ishte ky edicioni i 25-te i FLAKES . përfshirë në të shtyllat -Akademinë e Flakës ,Akademinë e Dr.Ibrahim Rugovës -Presidentit Historik,Talia e Flakës-Festivali i Dramës Shqipe, Film Flakën,Foto Flaka, Folk Flaka,Rock Flaka,dhe Xixat e Flakes,

Manifestimi”Flaka e Janarit”tani më ia ka dalë që të jetë njëra ndër ngjarjet më masive dhe me vlerat më të larta artistike në Kosovë,që mbledh rreth vetes me mijëra krijues të të gjithave shtyllave të Flakës shtyllave të sipër permendura. Të gjithë krijuesit më eminentë kombëtarë:- Teatrot Profesioniste Shqipëtare, të Kosovës , Shqipëprisë , Maqedonisë,dhe ne te gjitha trojet shqipëtare, me një fjalë nga çdo vend ku frymohet dhe flitet shqip; Shoqatat e Artistëve Figurativ të qyteteve të ndryshme Shqiptare, solistë dhe instrumentistë më kulmorë mbarëkombëtarë dhe letrare të mirënjohur shqiptarë të të gjitha llojeve letrare, subjekte dhe asociacione që i tubojnë krijuesit e të gjitha kategorive dhe zhanreve sikundër edhe dashamirët e të gjitha llojeve të arteve që aktualisht kultivohen dhe zhvillohen në tërë gjeografinë kulturore mbarëkombëtare shqiptare.

1.Vlen të përmendet kostoja e lartë e FLAKES , gjë e cila na obligon ta rishikojmë buxhetin që është caktuar për të,edhe pse ky vit ishte si asnjëherë më parë i mirë organizuar në nivele më të larta dhe i zgjeruar edhe në shtylla tjera të artit dhe me një vlerë bugjetore thuhetse gjysma e bugjetit te disa viteve më herët,por suksesi ishte më i madh se asnjëherë tjetër,dhe të drejtohem i në instanca më te larta siç është MKRS, edhe per arsyen sepse FLAKA shënoi 25-vjet dhe ende nuk ka hyrë në kalendarin e ngjarjeve të rëndësishme të MKRS.

2. Mendojmë se komuna e vetme nuk mund të përballojë shpendezimet e një manifestimi me përmasa mbarëkombëtare dhe me prurje kaq të mëdha që është FLAKA E JANARIT

3. Gjithëashtu është mire që të caktohet një vijë e veçante buxhetore për” Flaken e Janarit” në menyrë që mos të dëmtojë buxhetin e NJKRS.

17 Shkurt SHPALLJA e PAVARËSISË së Kosovës

Kremtimi i Ditës së Pavarësisë së Kosovës ishte aktiviteti i radhës së NJKRS-së. Ky manifestim është shëndërruar në tradicional tashme dhe bashkon rreth tij artistet, sportistët të rinj, fëmijët e shkollave me të cilët u mbajten në aktivitete të mrekullueshme.

Këtë vit në këtë Manifestim përveç performancave të artistëve vendas me reprizen e shfaqes Teatrale “JETE ME QERA” nga Teatri i Qytetit të Gjilanit, e begatuan edhe Baleti i Kosovës me Shfaqen “DASMA” ku mbi dhjetë vite nuk ka pasur shfaqje baleti në Gjilan, me një GALA Koncert–ROCK MUSIC–koncert i madh i cili u mireprit shumë mirë me një masë të jashtëzakonshme të masës së njerëzve që dolën ta përcjellin e që nuk mbahet në mend numër aq i madh, dhe Koncerti tjetër i madh i perbashket me trupë artistike dhe ansamble me muzikë popullore i cili gjithashtu u shfaq në sallën e Teatrit dhe është mirëpritur shumë mirë nga qytetarët, kritikët e kulturës –artit dhe mediumet. .

Pjesë e këtij aktiviteti ishin edhe Fëmijet me program shumë të mirë dhe të cilët vazdimisht janë pjesë e aktiviteteve të NJKRS.

Kalendari i aktiviteteve:

E hënë : 15.02.2016

Ora : 19:00

Vendi : Salla e Teatrit

Repriza e Shfaqes Teatrale “JETE ME QERA”

Trupa e Teatrit Gjilan

E martë : 16.02.2016

Ora : 19:00

Vendi : Salla e Teatrit

Baleti i Kosovës shfaq:
“DASMA”

E mërkurë : 17.02.2016

Ora 11:00

Vendi : Varrezat e Deshmoreve

Homazhe tek Varrezat e Deshmoreve dhe tek Lapidaret.

Ora 13:00

Vendi : Platoja e Teatrit

Koncert Festiv për Fëmijë

Ora 19:00

Vendi : Platoja e Teatrit

Koncert Festiv Rrok muzike me grupet e qytetit.

E enjte : 18.02.2016

Ora : 19:00

Vendi : Teatri i Qytetit

Koncert Festiv

Artistet e Gjilan – Artistet e Tetovë

Dita Përkujtimore e Dëshmoreve

Nata e Zjarreve po ashtu si ç'dovit u shënua me 5-6 Mars.
Për të përkujtuar të Rënët për Lirine e Atdheut dhe për të nderuar veprën e tyre u organizuan vizita nëpër lapidare, buste dhe varrezat e dëshmoreve nga Kryetari Lutfi Haziri, zyretare të tjere të lartë, OVL të UCK-se përfaqësues të shoqërisë civile, mediat dhe qytetarët. Në mbremje tek Kodra e Dëshmoreve në praninë e shumë pjesëmarrësve u bë nderja e zjarreve.

8 Marsi Dita ndërkombetare e Gruas

Në bashkëpunim me OJQ "Gruaja Hyjnore" NJKRS zhvilloi një aktivitet kulturor sensibilizues për të shënuar 8 Marsin Ditën Nderkombetare të Gruas.
Ky aktivitet pati si qëllim të sensibilizojë masën për rëndësinë dhe rolin që ka gruaja në shoqërinë tonë.
Në kuadër të këtij aktiviteti u zhvillua dhe Ekspozita Fotografike në të cilën tregohet roli që kanë pasur gratë Gjilanase në disa etapa të rëndësishme historike për shoqërinë tonë. Vlen të përmendet se ky aktivitet u zhvillua nën përkujdesjen e Kryetarit të Komunës së Gjilanit z. LUTFI HAZIRI.

15 Prilli Beteja e Zhegocit

Manifestim ky tradicional, në kuadër të aktiviteteve të NJKRS, u zhvillua me 15.04.2016 në Zhegoc. Për realizimin dhe mbarevajtje të manifestimit si gjithmone u përkujdesen NJKRS.-OVL të UCK dhe Këshilli i fshatit Zhegoc.

Këtë herë interesimi dhe pjesëmarrja e qytetarëve të Gjilanit ishte mjaft e lartë. Familjare të dëshmoreve, veprimtare të çështjes kombëtare, përfaqësues të shoqatave të dalë nga lufta, përfaqësues të Institucioneve lokale dhe qendrore, përfaqësues të subjekteve politike, shoqërisë civile ia shtuan edhe me shumë rëndësinë këtij manifestimi.

Aktivitetet filluan që në 10.04.2016 me:

Turneun në futboll të vogël i cili zhvillohet në Zhegoc.

Pastaj në 15.04.2016 u bë:

Homazhe tek Kodra e Dëshmoreve.

Zbulimi i pllakës Përkujtimore në fshatin Terboç.

Manifestimi qendror tek Lapidari në qendër të fshatit Zhegoc.

1.2.3 Maj Ditët e Agimit

Si ç'do vit tashme është bërë tradicional ky manifestim ,ai zhvillohet me datat 1-2-3 Maj Bashkepunetor i yni ne kete aktivitet është Shoqata “DITT E AGIMIT” Zheger.

Manifestimi zgjat tre dite dhe perbehet nga aktivitete te ndryshme sportive,kulturore,letrare,dhe shenimi i dites se shkolles.

Turniri Memorial “Edhe me sport e kujtojmë Agimin.

Ora e madhe Letrare ishte aktiviteti i radhes i cili e begatoi me njerëz te letrave dhe fjales se bukur kete Manifestim . ne kete aktivitet moren pjese shkrimtare e poete nga te gjitha viset.

Dita e trete e këtij manifestimi filloi me homazhe tek Shtatorja e dëshmorit “AGIM RAMADANI” ne qender te qytetit.

Me pas u shenua dita e shkolles qe mban po te njëjtin emer.

Tubimi qendror i cili dhe përmbyll manifestimin u zhvillua ne pranine e shume personaliteteve politike,familjareve te deshmoreve,perfaqesueseve te institucioneve lokale e qendrore,artiste e sportiste te lemive te ndryshme.

Ne kete tubim u be edhe shpallja e rezultateve dhe ndarja e cmimeve per garat e siperpermendura.

Ne fund per te pranishmit performuan artistet nga Estrada Shqiptare, dhe AKV te ndryshme.

1 Qershori “Lyra Fest”

Festivali i Femijeve “LYRA” u zhvillua me 1 Qershor ditën nderkombetare te femijeve.

Ky festival është bërë tradicional tashme dhe ka fituar nje reputacion te madh ne tere hapësiren. Nje mbështetje te madhe këtij festivali i jepet edhe nga Komuna dhe NJKRS.

11 - 15 Qershori „Dita e çlirimit” të qytetit tonë - Gjilanit

Agjenda e aktiviteteve te parapara nga 11-15 Qershor.

E shtune :11.06.2016

Ora :10:00

Vendi : Varrezat e qytetit

Lule per Beqen- ne 71-vjetorin e lindjes dhe 20-vjetorin e vdekjes.

Ora 11:00

Vendi :Gryka e Karadakut-Dunav

Manifestimi Rajonal I Poezise- TREKENDESHI POETIK I PAQES

E hene : 13.06.2016

Ora : 13:00

Vendi : Salla e Teatrit

LULJA dhe SHEGA

Shfaqje Teatrale per femije

E marte : 14.06.2016

Ora : 18:00

Vendi : Sheshi para Teatrit

Festivalit “GURRA POPULLORE”2016

(nata e pare)

E merkure :15.06.2016

Ora ; 09:00

Vendi : Varrezat e Deshmoreve,dhe lapidare

Homazhe ne Nderim te te Reneve per Liri.

Ora : 10:00

Salla e Kuvendit Komunal

Mbledhje Solemne e Kuvendit Komunal Gjilan.

Ora 11:00

Vendi :Restorant Planeti

Shallja e me te Dalluarve ne Sektorin e Sportit.

Edhe ky manifestim karakterizohet nga aktivitete te shumta kulturore e sportive duke filluar prej femijeve e deri tek te rriturit.

Aktivitete filluan te shtunen me 11 Qershor me Homazhe te varri i shkrimtarit te njohur BEQIR MUSLIU.

Ne kuadër te tij u zhvillua Festivali “GURRA POPULLORE” i cili numëron edicionin e tij te 13-te kete vit.

Festivali u zhvillua per dy dite rresht 14- 15.

Ne te moren pjese gjithsej 12 Ansamble nga mbare hapësira Shqiptare nga te cilat 8 prej tyre ishin ne konkurim.

Koncert Festiv per Femije

Edhe femijet iu gezuan Dites se Clirimit te Qytetit ku u zhvillua nje koncert madheshtor me kenge e valle per femije.

Nuk munguan as performancat akrobatike dhe animacionet te cilat jane mjaft atraktive per femijet.

Trekëndeshi Poetik i Paqes

Në fshatin e bukur kufitar Dunav si gjithmonë u zhvillua Trekëndeshi Poetik i Paqes. As këtë herë arti letrar nuk i mungoi vargut të aktivitetëve, poet, shkrimtarë dashamirë të letrave e nderuan këtë aktivitet me prezencën e tyre.

Ndarja e cmimit letrar “BEQIR MUSLIU”

Me këtë aktivitet të rëndësishëm letrar që zhvillohet nga zyra e Kryetarit të Komunes në bashkëpunim me Ars Klub “Beqir Musliu” filluan aktivitetet 15 qershorit për të pasuar me shume të tjera gjatë ditës.

Më të Dalluarit në Kulturë

Gjatë këtyre aktivitetëve për nder të Dites së Clirimit të qytetit të Gjilanit janë ndarë MIRENJOHJET për më të dalluarit gjatë periudhës Qershor 2015-2016 në sektorin e Kulturës. Prezenca e kryetarit të Komunës z. Lutfi Haziri dhe ndarja e mirënjohjeve personalisht nga kryetari për artistët, e bëri edhe më të rëndësishëm këtë aktivitet.

Gjatë gjithë kësaj periudhe 6-mujore AKV-të, Shoqatat dhe artistet e sferave të ndryshme kanë pasur aktivitete personale dhe përfaqesime në Festivale, Ekspozita, Panairë të organizuara brenda dhe jashtë vendit.

AKV Gjilani, AKV –ALBAFOLK, TAM –Gjilan, AKV –GURRA, Shoqata e Artit Pamor, Shoqata VARG e VI, Shkolla e Artit Pamor, Shkolla e Muzikës, OJQ “Gruaja Hyjnore” ARS Clubi “BEQIR MUSLIU”, OJQ “Lyra”, Zico TV

Një vend të rëndësishëm kanë zënë edhe aktivitete të tjera të cilat ne i kemi mbështetur në anë teknike, rezervimi, asistimi, përgatitja e sallës, përkujdesja profesionale, si: Akademi perkujtimore., Shfaqje të filmave dokumentarë kushtuar veprimtareve të ndryshëm, Konferenca shkencore, Koncerte të Sh.M.M-Gjilan, Ditët e Shkollave.

Ne si NJRKS i kemi përkrahur duke i mbështetur për realizimin e projekteve të tyre qoftë kolektive apo individuale. për botim, ekspozim, performim edhe me sigurimin e transportit dhe shërbimeve nëpërmjet kontraktoreve të komunës.

Të gjithë këta artiste vlen të falënderohen për përfaqesimin e denjë që i kanë bërë qytetit tonë edhe ne si institucion.